

SIGURI

Bisedë me gjeneralletënant Kadri Kastrati

FSK-së i mungojnë a

FSK-ja edhe për një kohë nuk do të jetë ushtri. Aktualisht jo të gjithë pjesëtarët e saj janë të pajisur me armë. Pavarësisht kësaj, FSK-ja është në proces të vazhdueshëm të ngritjes së kapaciteteve dhe ky progres është vlerësuar shumë edhe nga partnerët ndërkombëtarë

Valdrin Krasniqi
valdrin.krasniqi@gazetatribuna.com



Prishtinë, 3 mars - Ne jemi krenarë për atë që është arritur dhe do të vazhdojmë të punojmë shumë për të ecur përpara dhe për të përmirësuar profesionalizimin dhe aftësitë e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Kjo forcë është institucioni i sigurisë më i besuar në Kosovë. Ne jemi krenarë për këtë, por gjithashtu është një përgjegjësi e madhe. Kështu ka deklaruar në një bisedë për gazetën "Tribuna", komandanti i FSK-së, gjeneralletënant Kadri Kastrati. Ai ka thënë se FSK-ja është në proces të vazhdueshëm të ngritjes së kapaciteteve dhe ky progres i FSK-së është vlerësuar shumë nga partnerët ndërkombëtarë.

I pyetur se kur FSK do të

transferohet në ushtri, gjeneralletënant Kastrati thotë se me ndihmën dhe asistencën e Iniciativës për Reformën e Institucionit të Departamentit të Mbrojtjes të SHBA-ve (DIRI), Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë është duke u zhvilluar që nga marsi i vitit 2012. "Me punën e mëtejshme që do të vijë, ne presim që konkluzionet e përkohshme do të publikohen deri në Qershor të vitit 2013. Por ndryshimet që kemi bërë dhe që do të behën do të jenë transparente, dhe ky është qëllimi ynë që ato do të kryhen në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë si pjesë e një plani kalimtar. Është qël-

limi ynë për të ndihmuar me operacionet për mbështetje të paqes me BE dhe NATO-n", ka deklaruar komandanti.

Forcë profesionale, shumetnike dhe e besueshme

Pjesëtarët e FSK-së ende nuk janë të armatosur që të gjithë. Dhe ato armë që i posedojnë, janë të kalibrit të lehtë. "Aktualisht ne kemi armatim të lehtë. Për çdo rol të ardhshëm që do të kemi si FSK, ne do të shikojmë përsëri për pajisjet për të cilat ne kemi nevojë, dhe unë jam i sigurt se fondet do të jenë në dispozicion për të blerë pajisje të reja", është shprehur Kastrati.

Ai ka folur edhe për Kapacitetet Operacionale, të cilat thotë se FSK i ka arritur në bazë të kriterëve dhe objektivave të caktuar, dhe se si forcë është e gatshme që të reagojë çdo herë në bazë të misionit që ka. "Në momentin e duhur, NATO do të marrë një vendim për raportet e saj me FSK-në. Ne jemi mirënjohës për përpjekjet e partnerëve tanë për të na ndihmuar për të ecur përpara. Ne do të vazhdojmë të bashkëpunojmë ngushtë me miqtë dhe partnerët tanë, dhe ne do të jemi plotësisht të hapur me ta ashtu si ne do të shikojmë përpara", ka thënë kreu i FSK-së. Kastrati ka folur edhe për të

arriturat e deritashme të FSK-së. "Kemi zhvilluar Qendrën e Ekselencës për Kërkim-Shpëtim nga i cili do të përfitojë i gjithë rajoni. Ne jemi duke zhvilluar Trupën e nëniferëve si dhe kemi në aplikim Ligjin për pensione të pjesëtarëve të FSK-së. Gjatë vitit të kaluar kemi arritur që të dizajnojmë dhe vëmë në përdorim uniformën e re unikate dhe moderne, po ashtu kemi emërtuar kazermet si dhe kemi dizajnuar gradat, pra kemi punuar në çështjet e identitetit FSK-së", është shprehur gjeneralletënant Kastrati, duke shtuar se me punë dhe angazhim është arritur që FSK-ja të zhvillohet

Dy persona të plagosur, të dyshuarit u ikin policisë

Policia e Kosovës ka njoftuar se në qytetin e Prishtinës në rrugën "Rasim Kličina", të shtunën rreth orës 19:40 minuta dy persona kanë gjuajtur me armë zjari në drejtim të dy personave të tjerë, të cilët kanë mbetur të plagosur. Viktimat janë dërguar në Qendrën Klinike Universitare pasi që, siç njofton policia, njëri është

në gjendje të rëndë shëndetsore. Policia nëpërmjet një komunikate për media ka bërë të ditur se pjesëtarët e saj kanë dalë në vendngjarje, por nuk kanë arritur të zbulojnë motivet e kësaj veprë. "Policia në vendin e ngjarjes ka gjetur dhe konfiskuar një revole të tipit TT 7.62 mm, prodhim jugosllav dhe 13 gëzhoja të ka-

librit 9 mm dhe 7.65 mm". Pas konsultimit me prokurorin, policia ka bërë bastisjen e shtëpisë të të dyshuarit, mirëpo nuk kanë gjetur asgjë të dyshimit. Ndërsa te shtëpia e viktimës është gjetur dhe konfiskuar një shufër dhe një thikë. Sipas policisë, dy të dyshuarit kanë ikur me veturë nga vendi i ngjarjes.

Policia bllokoi 700 kg marihuanë

Forcat e policisë së portit dhe ato të sektorit të antidrogës në Durrës kanë bllokuar një sasi prej rreth 700 kg lëndë narkotike kanabis Sativa, që ishte fshehur në një kamion me targa maqedonase, me cak Italoë. Burime zyrtare nga drejtoria e policisë së qarkut të Durrësit bënë të ditur se kamioni tip DAF,

me targa maqedonase, është ndaluar për kontroll mbrejmjen e kaluar, teksa përgatitje për të vazhduar udhëtimin me traget drejt portit të Barit (Itali), transmeton BW. Sipas të njëjtave burime, droga e sekuestruar nuk është peshuar ende përfundimisht, por sasia e përafërt e saj arrin në rreth 700 kg.

mët e rënda

Rasti i Restelicës tregoi se FSK-ja është e aftë për të përballuar me gjendje shumë të vështira dhe t'i mbështesë qytetarët e Kosovës. Përpjekjet e shquara dhe profesionalizmi i FSK-së, në kërkimin dhe shpëtimin e viktimave të ortekut ishin gjithashtu të vlerësuara shumë nga KFOR-i. Gjithashtu në kemi intervenuar në Kërkim Shpëtim në ujëra, ku kemi nxjerrë nga lumenjtë dhe liqenet disa persona që kanë pësuar fatkeqësi

në forcë profesionale, shumetnike, forcë e besueshme, ashtu siç është e paraparë edhe me ligj.

Të gatshëm për të intervenuar


Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës disa herë kanë intervenuar në raste të fatkeqësive natyrore. Në kuadër të FSK-së vepron edhe njësi i Kërkim-Shpëtim, njësi kjo që deri tani u ka shpëtuar jetën dhjetëra qytetarëve.

"Rasti i Restelicës tregoi se FSK-ja është e aftë për të përballuar me gjendje shumë të vështira dhe t'i mbështesë qytetarët e Kosovës. Përpjekjet e shquara dhe profesionalizmi i FSK-së, në kërkimin dhe shpëtimin e viktimave të ortekut ishin gjithashtu të vlerësuara shumë nga KFOR-i. Gjithashtu në kemi intervenuar në Kërkim Shpëtim në ujëra, ku kemi nxjerrë nga lumenjtë dhe liqenet disa persona që kanë

pësuar fatkeqësi", ka pohuar komandanti i FSK-së. Sipas tij, zhvillimi i FSK-së është i bazuar në praktikën më të mira demokratike për të siguruar një "Forcë për të mirë" që është nën kontrollin demokratik civil dhe është e pranueshme për shtetin, fqinjët dhe NATO-n.

Për emërtimin ushtri, pritet vendimi i NATO-s

"Në momentin e duhur, NATO do të marrë një vendim për raportet e saj me FSK-në. Ne jemi mirënjohës për përpjekjet e partnerëve tanë për të na ndihmuar për të ecur përpara. Ne do të vazhdojmë të bashkëpunojmë ngushtë me miqtë dhe partnerët tanë, dhe ne do të jemi plotësisht të hapur me ta ashtu si ne do të shkojmë përpara", ka thënë kreu i FSK-së.



Nis gjykimi për grupin që grabiti kazinonë "Merkur"


Prishtinë, 3 mars - Në gjykatën Themelore të Gjilanit ka filluar procesi gjyqësor që lidhet me grabitjen e kazino "Merkur" në qytetin e Gjilanit. Nijazi Spahiu, Azem Spahiu, Ardian Bajrami, Shkëlzen Uruqi dhe Rasim Sylja po akuzohen për grabitje të 16 mijë eurove në kazino "Merkur", e cila ka ndodhur më 24 shkurt të vitit 2012. Kjo grabitje është cilësuar si spektakulare meqë gjithçka ishte bërë në mënyrë të organizuar. Prokurori i kësaj çështjeje, Shaban Spahiu, në aktakuzë i ngarkon Nijazi Spahiu, Azem Spahiu, Ardian Bajrami, Shkëlzen Uruqin dhe Rasim Sylën për veprën penale vjedhje grabitqare.

Sipas aktakuzës, të dyshuarit më 24 shkurt 2012 në lagjen "Dardania" në Gjilan, në bashkëveprim kanë kryer grabitjen në kazino "Merkur". Në aktakuzë më tej thuhet që grupi ka pasur një plan dhe marrëveshje paraprake, duke i ndarë edhe rolet dhe duke siguruar mjetet e përshtatshme për kryerjen e veprës si dorëza, maska etj.

Të pandehurit, sipas aktakuzës, kanë hyrë në kazino të armatosur dhe me maska dhe duke i drejtuar armët nën kanosje e kanë goditur të dëmtuarin Rr. SH, si dhe nën këtë kanosje kanë arritur të grabisin shumën e parave prej 16 mijë eurove. Sipas aktakuzës, të pandehurit, të hollat i kanë ndarë mes vete derisa si udhëheqës i grupit është cilësuar Rasim Sylja.

Avokati mbrojtës i të pandehurit Rasim Sylja, Masar Morina, në lidhje me këtë ka bërë të ditur për "Tribuna" që klienti i tij e ka mohuar veprën, duke shtuar që i pandehuri Rasim Sylja ditën kur ka ndodhur rasti, nuk ka qenë në

Sipas aktakuzës të dyshuarit më 24 shkurt 2012 në lagjen "Dardania" në Gjilan, në bashkëveprim kanë kryer grabitjen 16 mijë eurove në kazino "Merkur".



Generallejtnant Kadri Kastrati

Humb jetën një peshkatar

Polica e Kosovës ka bërë të ditur se të dielën ka humbur jetën një person me inicialet M.P., afro 50 vjeç, derisa po peshkonte buzë lumit Sitnica. "Rreth orës 11:45 është raportuar se në rrugën "Kalabria", saktësisht buzë lumit Sitnica, një person është gjetur pa shenja jete.

Bëhet fjalë për një qytetar i cili po peshkonte në këtë lumë", - ka bërë të ditur Avni Zahiti, zyrtar për informim në rajonin e Mitrovicës.

Pjesëtarët e policisë kanë dalë në vendngjarje. Sipas komunikatës së policisë, si shkaktar i aksidentit dyshohet të jetë

nxenia nga rryma elektrike, por ende asgjë nuk është e konfirmuar. "Shkaktar i aksidentit dyshohet se është rryma elektrike, por trupi është dërguar në obduksion në mjekësi ligjore dhe me urdhër të prokurorit është hapur si rast i vdekjes së dyshimtë", ka thënë Zahiti.

Kosovë. "Në aktakuzë Rasim Sylja cilësohet si udhëheqës i grupit, mirëpo ai nuk e pranon veprën penale që i vihet në barrë, pasi që atë ditë kur ka ndodhur rasti ai nuk ka qenë në Kosovë. Ai i ndodhej në Maqedoni atë ditë, qëndron edhe vula në pasaportën e tij që dëshmon që Rasimi nuk ndodhej në Kosovë" ka thënë Morina. Të gjithë të akuzuarit ndodhen në paraburgim që nga data 9 mars 2012, ndërsa vetëm njëri prej tyre është në arrest shtëpiak. Seanca e radhës është caktuar për 13 mars. (N.B.)